



Kingdom of the Netherlands



## Raport vjetor mbi denoncimet e ardhura për sistemin shëndetësor në portalet shëndetësore [shendeti.com.al](http://shendeti.com.al) dhe [propacientit.com](http://propacientit.com)

Gusht 2018

Shoqata "Together for Life" ka zbatuar projektin "Forcimi i demokracisë në sistemin shëndetësor duke respektuar të drejtat e njeriut", i cili mbështetet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta. Projekti filloi në muajin gusht 2017 dhe u mbyll në muajin korrik 2018.

Gjatë kësaj periudhe, shoqata "Together for Life" përmes aktiviteteve të kryera prej saj në terren dhe në bashkëpunim me shoqatat e pacientëve ka synuar të rrisë informimin e pacientëve për çështjet e të drejtave në sistemin shëndetësor. Gjithashtu është synuar përmes shkrimeve, si rritja e njohurive të pacientëve për sistemin shëndetësor, por gjithashtu është synuar që të rritet transparenca nga ana e institucioneve të këtij sistemi.

Përgjatë periudhës gusht 2017 - korrik 2018, gazeta "Shëndet+" ka mbledhur denoncimet e ardhura nga pacientët në të gjithë Shqipërinë dhe ka realizuar një raport për të bërë të ditur se cili është perceptimi i shqiptarëve për sistemin e shëndetësisë, por edhe për të treguar përballjen me këtë sistem.

Siç do të shihet edhe më poshtë, ankesat kryesore të shtetasve shqiptare ndahen në 10 kategori dhe përkatësisht:

1. Mungesa e ilaçeve, medikamenteve
2. Mungesa e infrastrukturës
3. Mungesë e pajisjeve
4. Keqmenaxhim të institucioneve shëndetësore
5. Mungesë e burimeve njerëzore
6. Mungesë politikash shëndetësore parandaluese



Kingdom of the Netherlands



7. Mosfiksionim të politikave shëndetësore
8. Shkelje e të drejtave të pacientëve (njeriut)
9. Mohim të së drejtës së fjalës
10. Mungesë informacioni

Nga ana e shoqatës "Together for Life", pas marrjes së denoncimeve të pacientëve, është realizuar edhe verifikimi në terren i këtyre denoncimeve. Më pas, të gjitha denoncimet e provuara janë publikuar në faqen online të gazetës "Shëndet+" si dhe në portalin [propacientit.com](http://propacientit.com).

Një gjë e tillë ka sjellë në vijimësi edhe rritjen e numrit të denoncimeve, siç do të shihet edhe më pas.

### Gusht 2017

Me fillimin e projektit, gjatë muajit gusht të vitit 2017, në redaksinë e gazetës "Shëndet+" kanë mbërritur tre denoncime<sup>1</sup>, të cilat më pas janë ndjekur nga gazetarët në terren.

Këto denoncime kishin si shqetësim të tyre kryesor:

- Mungesën e ilaçeve
- Mungesën e infrastrukturës

Praktikisht, nga pacientët është denoncuar mungesa e ilaçeve për pacientët me parkinson. Për këtë çështje gazetarët e Shëndet+ komunikuan edhe me Ministrinë e Shëndetësisë të cilët konfirmuan mungesën, teksa deklaruan se ishin marrë masat që ky ilaç të mos mungonte më për këta pacientë.

Ndërkohë, një denoncim tjetër ishte për qendrën shëndetësore të Kamzës, e cila pati mungesë serumesh në urgjencë, por ndërkohë që krevatët e saj ishin të ndryshkur pavarësisht se për këtë qendër shëndetësore ishin investuar 840 milionë lekë.

QSUT-ja ishte një institucion tjetër në qendër të vëmendjes së denoncimeve për çështjet infrastrukturore. Foto të ardhura nga pacientët treguan plasjen e tubacioneve në një moment shiu.

---

<sup>1</sup> 2 gusht 2017 - Pacientët me Parkinson, pa ilaçe. MSH: Kompania ishte gati të çregjistronte barin

<https://shendeti.com.al/pacientet-me-parkinson-pa-ilace-msh-kompania-ishte-gati-te-crregjistronte-barin/>

11 gusht 2017 - Krevate të ndryshkur dhe urgjencë pa serum. Si u vodhën 840 milionë lekë të QSH të Kamzës  
<https://shendeti.com.al/krevate-te-ndryshkur-dhe-urgjence-pa-serum-si-u-vodhen-840-milione-leke-te-qsh-te-kamzes/>

13 gusht 2017 - Plasin tubacionet në QSUT. Dimri mund të rrezikojë institucionin

<https://shendeti.com.al/plasin-tubacionet-ne-qsut-dimri-mund-te-rrezikoje-institucionin/>



Kingdom of the Netherlands



## Shtator 2017

Muaji shtator solli nëntë denoncime<sup>2</sup> nga pacientët. Në përgjithësi këto denoncime bënin fjalë për:

- Mungesë infrastrukture
- Mungesë pajisjesh
- Mungesë ilaçesh
- Keqmenaxhim të institucioneve.
- Ndërkohë në një rast çështja është zgjidhur pas denoncimit në faqen "ProPacientit".

Kështu, në denoncimet e ardhura gjatë muajit shtator përfshihen foto denoncuese nga shërbimi i urgjencës kirurgjikale, të cilat tregojnë pajisje dhe shtretër në gjendje shumë të rëndë.

Mungesa e mjekimit ka qenë problematike edhe këtë muaj për hemofilikët, të cilët kanë vazhduar të denoncojnë faktin se sërisht ka pasur mungesë të faktorit, tepër të rëndësishëm për kurimin e tyre dhe pa të cilin jeta e tyre është në rrezik. Denoncimet për mungesën e faktorit janë jo të pakta.

Nga ana tjetër mungesa e pajisjeve ka qenë gjatë muajit shtator në qendër të denoncimeve, ku përfshihen këtu mungesa e shtretërve për të operuarit, mungesa e transportit për të sëmurët etj.

Problematike ka qenë edhe mënyra e menaxhimit të punëve në QSUT, teksa pacientët kanë denoncuar se pas orës 16:00 në këtë institucion funksionon vetëm ekoja dhe grafia e urgjencës duke krijuar një fluks të madh, por duke përbërë një problem sidomos për fëmijët e vegjël.

---

<sup>2</sup> 8 shtator 2017 - Në faqen në facebook të "Pro Pacientit" kanë mbërritur disa foto denoncuese nga shërbimi i Urgjencës Kirurgjikale, për gjendjen e pajisjeve dhe shtretërve.

<https://shendeti.com.al/sherbim-me-koncesion-instrumentet-kirurgjikale-ne-qsut-shtrese-ndryshku/>

11 shtator 2017 - Shërbim me koncesion/ Instrumentet kirurgjikale në QSUT, shtresë ndryshku

<http://propacientit.com/sherbim-me-koncesion-instrumentat-kirurgjikale-ne-qsut-shtrese-ndryshku/>

22 shtator 2017 - Pas denoncimit të Pro Pacientit, reagon QSUT/ Instrumente të reja kirurgjikale për urgjencën

<http://propacientit.com/pas-denoncimit-te-pro-pacientit-reagon-qsut-instrumenta-te-reja-kirurgjikale-per-urgjencen/>

9 shtator 2017- Infeksionet spitalore, flasin specialistët: Jemi përmirësuar por larg nivelit evropian

<http://propacientit.com/infeksionet-spitalore-flasin-specialistet-jemi-permiresuar-por-larg-nivelit-europian/>

14 shtator 2017 - Mungesa që u kushton shtrenjtë hemofilikëve. Sërisht pa faktor

<https://shendeti.com.al/mungesa-qe-u-kushton-shtrenjte-hemofilikeve-serish-pa-faktor/>

15 shtator 2017 - Shëndetësia publike në krizë/ Më shumë të operuar se shtretër, barela në korridore

<http://propacientit.com/shendetesia-publike-ne-krize-me-shume-te-operuar-se-shtreter-barrela-ne-korridore/>

20 shtator 2017 - QSUT/ Pas orës 16:00 punon vetëm eko dhe grafia e urgjencës. Problem fëmijët

<https://shendeti.com.al/qsut-pas-ores-1600-punon-vetem-eko-dhe-grafia-e-urgjences-problem-femijet/>

21 shtator 2017 - Foto lajm/ Sfidat e pacientëve dhe personelit në QSUT

<http://propacientit.com/foto-lajm-sfidat-e-pacienteve-dhe-personelit-ne-qsut/>

27 shtator 2017 - Tualetet në spitalin e Traumës, burim infeksionesh. 8 miliardë lekë investim për fasadë

<https://shendeti.com.al/tualetet-ne-spitalin-e-traumes-burim-infeksionesh-8-miliarde-leke-investim-per-fasade/>



Kingdom of the Netherlands



Një denoncim i rëndësishëm gjatë këtij muaji kishte të bënte me faktin që instrumentet kirurgjikale në QSUT kishin shtresë ndryshku. Dhjetë ditë pas këtij denoncimi të publikuar në faqen e ProPacientit, QSUT ka reaguar, duke blerë dy instrumente të reja për urgjencën.

### Tetor 2017<sup>3</sup>

Në muajin tetor ka pasur katër denoncime në portalet shëndetësore shëndeti.com.al dhe propacientit.com.

Gjatë këtij muaji denoncimet kanë qenë në lidhje me:

- Mungesën e burimeve njerëzore në spitale
- Mungesën e infrastrukturës
- Keqmenaxhimin e institucioneve shëndetësore

Ndryshe nga muajt e mëparshëm, në tetor ka ardhur denoncim edhe nga stafet e institucioneve shëndetësore për mungesë të burimeve njerëzore. Një situatë e tillë u krijua pas dorëheqjes së të gjithë drejtorëve të spitaleve pasi Kryeministri i vendit e kërkoi një gjë të tillë, pa marrë parasysh pasojat e mungesës së drejtuesve në këto institucione.

Gjithashtu, po në muajin tetor kanë vazhduar ankesat për mungesën e infrastrukturës në institucionet shëndetësore, ku në qendër të vëmendjes kanë qenë Urologjia, si dhe Spitali i Sëmundjeve të Brendshme dhe Spitali Infektiv në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë.

Ashtu si dhe në muajt e mëparshëm, edhe këtë herë është denoncuar problematika e tualeteve në spitale, të cilat bëhen burim infeksioni për të sëmurët. Ndërkohë, një problematikë tjetër ka qenë infektivi dhe sëmundjet e brendshme, muret e të cilave kanë zënë myk, pavarësisht se vite më parë nga ish-ministri i Shëndetësisë u premtua një investim prej miliona eurosh.

Një problematikë tjetër e muajit tetor ka qenë edhe shitja e duhanit në oborret e spitaleve nga shitësit ambulantë. Pavarësisht se një institucion shëndetësor, kjo është parë si normale nga drejtuesit e institucioneve, ndërkohë që vetë pacientët e kanë denoncuar si një promovim të

---

<sup>3</sup> 2 tetor 2017 - Nuk ka kush firmos borderonë. Punonjësit e spitaleve ngelen pa paga

<http://propacientit.com/nuk-ka-kush-firmos-borderone-punonjesit-e-spitaleve-ngelen-pa-paga/>

10 tetor 2017 - Tualetet e shërbimit të urologjisë, jashtë çdo standardi

<https://shendeti.com.al/tualetet-e-sherbimit-te-urologjise-jashte-cdo-standardi/>

16 tetor 2017 - 3 vite nga premtimi miliona euro i ish-ministrit, 6-katëshin dhe infektivin i zë myku

<https://shendeti.com.al/3-vite-nga-premtimi-miliona-euro-i-ish-ministrit-6-kateshin-dhe-infektivin-i-ze-myku/>

18 tetor 2017 - Duhani promovohet edhe në oborret e spitaleve tona

<https://shendeti.com.al/duhani-promovohet-edhe-ne-oborret-e-spitaleve-ona/>



Kingdom of the Netherlands



duhanit në një ambient aspak të përshtatshëm dhe ku duhet patjetër të promovohet jeta e shëndetshme.

## Nëntor 2017<sup>4</sup>

Muaji tetor pati gjashtë denoncime në portalet. Këto denoncime kishin në vëmendje të tyre çështje të tilla si:

- Mungesën e politikave shëndetësore parandaluese
- Mosfunksionimin e politikave shëndetësore
- Mungesën e infrastrukturës, pajisjeve
- Keqmenaxhimin e institucioneve.

Mungesa e ilaçeve është sërish problematike gjatë muajit nëntor duke rikthyer vëmendjen tek hemofilikët, të cilët kanë vazhduar të mbeten pa ilaçe dhe duke vënë në rrezik jetën e tyre. Ndërsa kanë kërkuar prononcim zyrtar për këtë çështje, gazetarët e "Shëndet+" janë përballur me heshtje nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

Mungesë ilaçesh kanë denoncuar edhe të sëmurët me kancer gjiri, numri i të cilëve vijon në rritje. Rezulton se pavarësisht se nga ana e institucioneve shëndetësore pretendohet rritje e numrit të ilaçeve të dhëna për këta pacientë, ndërkohë mungojnë politikat shëndetësore parandaluese, të cilat po çojnë në rritje të numrit të grave që po vuajnë nga një sëmundje e tillë.

Gjithashtu, denoncim në këtë muaj ka pasur nga qyteti i Shkodrës, ku pacientët kanë sjellë pamje nga qendra shëndetësore në fshatra, ku situata duket më mjerane se në kohërat e luftës.

Gjatë muajit nëntor është ngritur edhe problematika e sistemit të referimit për të sëmurët diabetikë. Këtyre pacientëve u duhet të udhëtojnë drejt Tiranës nga i gjithë vendi për të siguruar marrjen e rimbursimit, pasi për ilaçe të caktuara, ky rimbursim mund të bëhet vetëm në QSUT

---

<sup>4</sup> 2 nëntor 2017 - Ndërgjegjësimi ndaj kancerit të gjirit, mes mungesës së ilaçeve dhe numrit në rritje  
<https://shendeti.com.al/ndergjegjesimi-ndaj-kancerit-te-gjirit-mes-mungeses-se-ilaceve-dhe-numrit-ne-rritje/>

2 nëntor 2017 - Shëndetësia falas në Shkodër, pamje shokuese nga qendra shëndetësore  
<https://shendeti.com.al/shendetesia-falas-ne-shkoder-pamje-shokuese-nga-qendra-shendetesore/>

7 nëntor 2017 - Rrezatimi, ky rrezik i heshtur dhe i neglizhuar nga shqiptarët  
<https://shendeti.com.al/rrezatimi-ky-rrezik-i-heshtur-dhe-i-neglizhuar-nga-shqiptaret/>

17 nëntor 2017 - 45-vjeçari dorëzohet përballë diabetit, në mëshirë të qindarkave ndihmë nga kushdo  
<https://shendeti.com.al/45-vjecari-dorezohet-perballe-diabetit-ne-meshire-te-qindarkave-ndihme-nga-kushdo/>

27 nëntor 2017 - Skandali me mungesën e ilaçeve, pacientët hemofilikë po invalidizohen  
<https://shendeti.com.al/skandali-me-mungesen-e-ilaceve-pacientet-hemofilike-po-invalidizohen/>

30 nëntor 2017 - Pacientët me diabet bëjnë qindra km për një konsultë, Toti: Kërkohet ndryshim protokollit  
<https://shendeti.com.al/pacientet-me-diabet-bejne-qindra-km-per-nje-konsulte-toti-kerkohet-ndryshim-protokollit/>



Kingdom of the Netherlands



dhe jo në spitalet e tjera bashkiake apo rajonale. Një gjë e tillë sjell një barrë më të madhe për këta të sëmurë ndërkohë që sjell edhe fluks në Qendrën Universitare më të madhe në vend. Një nga të sëmurët me diabet ka denoncuar edhe faktin se i duhet të mbledhë para për të trajtuar sëmundjen e tij.

## Dhjetor 2017<sup>5</sup>

Gjatë muajit dhjetor pati vetëm 4 denoncime, me një përqendrim të tyre në:

- Denoncim për mungesë ilaçesh
- Mungesë infrastrukture

Nga ana e shoqatës së të verbërve është denoncuar fakti që nga ana e shtetit për ta ka shumë pak shërbime dhe se ata kanë nevojë për më tepër rimbursime dhe më tepër mundësi për kontrolle shëndetësore në mënyrë që të bëjnë një jetesë më normale.

Ndërkohë, pacientët me talasemi kanë kërkuar gjatë këtij muaji një rimbursim të medikamenteve të reja në mënyrë që të mund të vijojnë trajtimin e tyre. Nga ana e mjekëve ndërkohë për këtë çështje është theksuar fakti se duhen strategji të reja për frenimin e këtyre sëmundjeve.

Pacientët me hemofili kanë vijuar të kenë mungesë të faktor të nevojshëm për mbijetesën e tyre dhe për trajtimin. Vijimi i një jete normale në kushtet e mungesës së ilaçeve është i pamundur për pacientët hemofilikë. Mungesat e shumta të ilaçeve jetësore për ta sjell shumë probleme. Në bazë të deklaratave të mjekëve dhe pacientëve, një pjesë e këtyre të fundit rezulton se janë invalidizuar si pasojë e sasisë së pamjaftueshme me medikamente.

Gjithashtu rezulton se një pjesë e mirë e të sëmurëve me hemofili janë larguar nga Shqipëria për shkak të mungesës së ilaçeve.

Edhe nga qyteti i Lushnjës ka ardhur një denoncim në të cilin raportohet për kushtet jo të mira në pediatri në këtë qytet. Në një video të dërguar nga një lexuese tregohen qartë shtretërit tejet të amortizuar, muret që i ka zënë myku dhe ndriçuesit e dhomës të dëmtuar.

---

<sup>5</sup> 4 dhjetor 2017 - "Na mundësoni të lexojmë libra me sytë tuaj", mesazhi prekës i të riut dhe shëndeti i të verbërve <https://shendeti.com.al/na-mundesoni-te-lexojme-libra-me-syte-tuaj-mesazhi-prekes-i-te-riut-dhe-shendeti-i-te-verberve/>

7 dhjetor 2017 - Pacientët me talasemi thirrje qeverisë: Të rimbursohet medikamenti i ri <https://shendeti.com.al/pacientet-me-talasemi-thirrje-qeverise-te-rimbursohet-medikamenti-i-ri/>

9 dhjetor 2017 - Shëndetësia falas në Lushnje? Qytetarët denoncojnë amortizimin në pediatri <https://shendeti.com.al/shendetesia-falas-ne-lushnje-qytetaret-denoncojne-amortizimin-ne-pediatri/>

21 dhjetor 2017 - Pacientët me hemofili sërish pa faktorë, "QSUT i mban shpresat tek donatorët" <https://shendeti.com.al/pacientet-me-hemofili-serish-pa-faktore-qsut-i-mban-shpresat-tek-donatore/>



Kingdom of the Netherlands



Denoncimet nga qytete të ndryshme tregojnë edhe një herë jo vetëm situatën e shëndetësisë në vendin tonë, por edhe rritjen e njohurive të njerëzve për mekanizmat denoncues, si dhe rritjen e besimit të tyre në faqet shëndetësore shendeti.com.al dhe propacientit.com

## Janar 2018<sup>6</sup>

Muaji janar ka sjellë një rritje të numrit të denoncimeve. Kështu, përgjatë fillimit të vitit ka pasur tetë denoncime, ndërsa këto lidhen me:

- Keqmenaxhimin e institucioneve shëndetësore
- Keqfunksionim të politikave shëndetësore
- Mungesën e infrastrukturës

Problematika e largimit të mjekëve dhe infermierëve nga Shqipëria kanë qenë në vëmendje të këtij muaji. Ka rezultuar një rritje e numrit të mjekëve që largohen, ndërkohë që është kërkuar rritja e pagës për infermierët në mënyrë që këta të fundit të mos largohen nga Shqipëria.

Mungesa e infrastrukturës vazhdon të mos mungojë teksa pacientët kanë denoncuar faktin se u duhet të përdorin rezistenca për ngrohje për shkak se sistemi i ngrohjes së QSUT-së mbahet i fikur. Pamjet e sjella nga denoncimet tregojnë rezistencat dhe ngrohës të tjerë pranë krevateve, të cilat përdoren nga pacientët për të përballuar të ftohtin dimëror.

---

<sup>6</sup> 15 janar 2018 -MSHMS nuk zbaton vendimin për paketimin e produkteve të duhanit  
<https://shendeti.com.al/mshms-nuk-zbaton-vendimin-per-paketimin-e-produkteve-te-duhanit/>

16 janar 2017 - Manastirliu dështon me premtimin e 100 ditëve të para  
<https://shendeti.com.al/manastirliu-desh-ton-me-premtimin-e-100-diteve-te-para/>

16 janar 2017 - Shqipëria ka infermierë, “që të mos largohen të tjerë, duhen stimuluar me rritjen e pagës”  
<https://shendeti.com.al/shqiperia-ka-infermiere-qe-te-mos-largohen-te-tjere-duhen-stimuluar-me-rritjen-e-pages/>

16 janar 2017 - Qendra Spitalore Elbasan, penalizohet nga gjykata për 23 raste të zgjidhjes së kontratës së punës  
<https://shendeti.com.al/qendra-spitalore-elbasan-penalizohet-nga-gjykata-per-23-raste-te-zgjidhjes-se-kontrates-se-punes/>

17 janar 2017 - Beqaj dhe goditja e fundit për diabetikët. Ministria që i kërkoi MSh-së t’i japë fund justifikimeve  
<https://shendeti.com.al/beqaj-dhe-goditja-e-fundit-per-diabetiket-ministrja-qe-i-kerkoi-msh-se-ti-jape-fund-justifikimeve/>

18 janar 2018 - Pacientët përdorin rezistenca, sistemi i ngrohjes mbahet fikur në QSUT  
<https://shendeti.com.al/pacientet-perdorin-rezistenca-sistemi-i-ngrohjes-mbahet-fikur-ne-qsut/>

24 janar 2018 - Pacientët në QSUT të rrezikuar nga mbetjet spitalore, tualetet përdoren për magazinim të përkohshëm  
<https://shendeti.com.al/pacientet-ne-qsut-te-rrezikuar-nga-mbetjet-spitalore-tualetet-perdoren-per-magazinim-te-perkohshem/>

25 janar 2018 - Shifra të reja/ 2013-2017: 3-fishohet numri i mjekëve të larguar  
<http://propacientit.com/shifra-te-reja-2013-2017-3-fishohet-numri-i-mjekeve-te-larguar/>



Kingdom of the Netherlands



Mbetjet spitalore janë vlerësuar si problematike, teksa ka treguar për një keqmenaxhim të spitaleve teksa është parë se tualetet e këtyre institucioneve janë përdorur si magazina për këto mbetje. Denoncimi këtë radhë ka ardhur nga vetë stafet e spitaleve, dhe jo nga pacientët.

Çështja e rimbursimit të fishave dhe fëmijëve me diabet ka qenë një nga problematikat e ndjekura nga ana e portaleve shëndetësore, ndërsa është parë se është dhënë një zgjidhje nga ana e ministres së shëndetësisë duke u konsideruar kështu edhe një rast suksesi.

Nga ana tjetër, nga Elbasani, stafi mjekësor ka bërë të ditur faktin se Qendra Spitalore e këtij qyteti është penalizuar nga gjykata për zgjidhjen e 23 kontratave të punës.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka qenë në vëmendje këtë muaj me vendimet dhe mosvendimet e saj lidhur me çështjet e produkteve të duhanit por edhe të "lirimit të territoreve të zaptuara nga ngrehinat dhe aktivitete gjithfarësh brenda spitaleve publike". Të dyja këto çështje denoncohet të kenë dështuar.

## Shkurt 2018<sup>7</sup>

Gjatë muajit shkurt në portalet shëndetësore ka pasur 6 denoncime, të përmbledhura në:

- Denoncime për keqfunksionim të institucioneve shëndetësore
- Mosdhënie informacioni

Fruthi ka qenë një problematikë e rëndësishme gjatë muajit shkurt të këtij viti. Nga ana e mediave është dhënë alarmi e gjithsesi, stafi mjekësor ka denoncuar faktin se ka marrë urdhër të prerë që të mos japë asnjë informacion për situatën e fruthit në vend. 162 raste të konfirmuara me fruth dhe dy viktima ka qenë situata e epidemisë së fruthit që përfshiu vendin tonë që prej janarit. Ky urdhër u dha jo vetëm për mjekët e shërbimit terciar, pra QSUT, por edhe për Poliklinikat e

---

<sup>7</sup> 5 shkurt 2018 - KLSH "nxin" shëndetësinë: Mungojnë shërbimet, pacientët kanë perceptim negativ!

<http://propacientit.com/klsh-nxin-shendetesine-mungojne-sherbimet-pacientet-kane-perceptim-negativ/>

6 shkurt 2018 - PPP-të dështim. Shteti asnjë manual kontrolli për paketat shëndetësore që financon

<http://propacientit.com/ppp-te-deshtim-shteti-asnje-manual-kontrolli-per-paketat-shendetesore-qe-financon/>

6 shkurt 2018 - Karta e shëndetit, dokument jo efikas për marrjen e shërbimeve shëndetësore

<http://propacientit.com/karta-e-shendetit-dokument-jo-efikas-per-marrjen-e-sherbimeve-shendetesore/>

7 shkurt 2018 - Sistemi i referimit i çakorduar, Ministria merr masa disiplinore ndaj mjekëve

<http://propacientit.com/sistemi-i-referimit-i-cakorduar-ministria-merr-masa-disiplinore-ndaj-mjkeve/>

14 shkurt 2018 - Infermierët e QSUT kërkojnë protesta për tarifën e parkimit, të frikësuar për vendin e punës

<https://shendeti.com.al/infermieret-e-qsut-kerkojne-protesta-per-tarifen-e-parkimit-te-frikesuar-per-vendin-e-punes/>

26 shkurt 2018 - Urdhër nga lart, "asnjë informacion për situatën e fruthit"

<https://shendeti.com.al/urdher-nga-lart-asnje-informacion-per-situaten-e-fruthit/>



Kingdom of the Netherlands



kryeqytetit, ku nga shërbimet e infektivit mjekët pohojnë se kanë marrë urdhër që të mos flasin për epidemi, duke refuzuar dhënien e çdo lloj informacioni.

Nga ana tjetër, stafi mjekësor ka denoncuar problemet me sistemin e referimit, duke deklaruar se po ndëshkohen pa të drejtë nga Ministria, ndërkohë që në të vërtetë është sistemi ai që nuk funksionon. Edhe infermierët kanë denoncuar padrejtësitë ndaj tyre, teksa janë shprehur nën zë për tarifën e parkimit, teksa deklaruan se druhen për vendin e punës nëse flasin hapur.

Denoncimet e tjera lidhen qoftë me mosfunksionimin e kartës së shëndetit pavarësisht investimit gjigant të qeverisë në të, ashtu edhe me mungesën e shërbimeve dhe perceptimin negativ të pacientëve për sistemin shëndetësor.

Një problematikë e madhe ka qenë pikërisht çështja e keqmenaxhimit, e cila ka vijuar edhe me PPP-të, për të cilat deklarohet se shteti nuk ka asnjë manual kontrolli për paketat shëndetësore që financon, gjë që çon edhe në abuzime të mëdha në sistemin shëndetësor.

## Mars 2018<sup>8</sup>

Muaji mars shënoi 8 denoncime, të cilat përmblihen në:

- Keqmenaxhim të institucioneve shëndetësore
- Mungesë ilaçesh
- Mungesë infrastrukture.

---

<sup>8</sup> 2 mars 2018 - Mjekët denoncojnë për “Pro Pacientit”: Nuk jemi paguar për ditët e patronazhimit  
<https://shendeti.com.al/mjeket-denoncojne-per-pro-pacientit-nuk-jemi-paguar-per-ditet-e-patronazhimit/>

9 mars 2018 - Shqetësim që prej 2015-s. Mungon sërish trinitrina në QSUT

<https://shendeti.com.al/shqetesim-qe-prej-2015-s-mungon-serish-trinitrina-ne-qsut/>

10 mars 2018 - Vazhdojnë denoncimet: Të tjera ilaçe jetëshpëtuese mungojnë në farmacitë tona

<https://shendeti.com.al/vazhdojne-denoncimet-te-tjera-ilace-jeteshpetuese-mungojne-ne-farmacite-tona/>

17 mars 2018 - Të shembet fasada e shëndetësisë falas/ Brenda QSUT-së, pacientët detyrohen t'i blejnë ilaçet

<https://shendeti.com.al/te-shembet-fasada-e-shendetesise-falas-brenda-qsut-se-pacientet-detyrohen-ti-blejne-ilacet/>

19 mars 2018 - Pajisjet ekzaminuese dhe citostatikët, sfida për trajtimin e fëmijëve me tumore

<https://shendeti.com.al/pajisjet-ekzaminuese-dhe-citostatiket-sfida-per-trajtimin-e-femijeve-me-tumore/>

27 mars 2018 - Spitali pagoi mirëmbajtjen por nuk punoi asnjë ditë. Vihet në punë pas 4 vitesh shintigrafia

<https://shendeti.com.al/spitali-pagoi-mirembajtjen-por-nuk-punoi-asnje-dite-vihet-ne-pune-pas-4-vitesh-shintigrafia/>

29 mars 2018 - “Puno në korridor, dhoma është e imja”, drejtoresha nxjerr mjeken jashtë

<http://propacientit.com/puno-ne-korridor-dhoma-eshte-e-imja-drejtoresha-nxjerr-mjeken-jashte/>

30 mars 2018 - Portali ngatërron keq infermierët

<http://propacientit.com/portali-ngaterron-keq-infermieret/>



Kingdom of the Netherlands



Mjekët kanë vazhduar të jenë denoncues të keqmenaxhimit të institucioneve shëndetësore, teksa deklarojnë se nuk paguhen për punën që ata kryejnë lidhur me patronazhimin.

Infermierët gjithashtu kanë denoncuar shkeljet që janë bërë ndaj tyre nga ana e portaleve shtetërore që në fakt dueht të jenë orientues për ta.

Ndërkohë çështjet e keqmenaxhimit vijojnë teksa nga stafi mjekësor është denoncuar rasti i një mjekeje të nxjerrë për të punuar në korridor në qendrën shëndetësore, duke shkaktuar kështu njëkohësisht edhe shkelje të të drejtave të pacientit, duke qenë se shkeljet privatësia e pacientit.

Keqmenaxhimi është denoncuar edhe për rastet e pajisjeve në Sanatorium. Në këtë spital rezulton se është paguar mirëmbajtja e pajisjes shintigrafi për katër vjet rresht, megjithëse kjo pajisje nu është vënë asnjë ditë në punë.

Blerja e ilaçeve për shkak të mungesës së tyre vijon të jetë një problematikë e madhe në denoncimet e këtij muaji. Pacientët denoncojnë faktin se detyrohen t'i blejnë vetë ilaçet ndërkohë që mungesat e ilaçeve denoncohet të ndodhin jo vetëm në spitale, por edhe në farmaci. Një tjetër mungesë e denoncuar e këtij muaji ka qenë edhe ajo e trinitinës si medikament jetëshpëtues për të sëmurët me zemër.

## Prill 2018<sup>9</sup>

Në muajin prill 2018 kemi 4 denoncime, të përmbledhura si çështje:

- Keqmenaxhim të institucioneve
- Mosfunksionim të politikave shëndetësore
- Mungesë pajisjesh.

Prishja e aparaturave ka qenë një nga denoncimet e këtij muaji në portalin shëndetësor propacientit.com. Mosfunksionimi i aparaturave ka qenë gjithnjë në qendër të vëmendjes së portaleve, por gjithnjë rregullimi i tyre ka kërkuar kohë të gjata. Nga ana e pacientëve ka

---

<sup>9</sup> 12 prill 2018 - Prishet skopia në Qendrën Shëndetësore të Specialiteteve nr.1

<http://propacientit.com/prishet-skopia-ne-qendren-shendetesore-te-specialiteteve-nr-1/>

19 prill 2018 - Mungesë organizimi apo informacioni?! Radhë të gjata në Spitalin Francez

<http://propacientit.com/mungese-organizimi-apo-informacioni-radhe-te-gjata-ne-spitalin-francez/>

19 prill 2018 - Valë shkarkimesh në shëndetësi

<http://propacientit.com/vale-shkarkimesh-ne-shendetesi/>

23 prill 2018 - Dhjetëra infermierë të painformuar në dyert e MSHMS

<http://propacientit.com/dhjetra-infermiere-te-painformuar-ne-dyert-e-mshms/>



Kingdom of the Netherlands



vazhduar denoncimi për këtë problematikë në një prej qendrave të shëndetësore të specialiteteve në Tiranë.

Një tjetër problematikë ka qenë mungesa e orientimit të pacientëve në spitalin francez në QSUT, e cila ka shkaktuar radhë të gjata pritjeje për të gjithë ata që kanë kërkuar shërbimesh.

Infermierët kanë pasur sërish arsye për të denoncuar në këtë muaj, teksa nga ankesat e mbërritura në redaksi rezultoi se urdhri i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për përzgjedhjen e vendit të punës ka krijuar një konfuzion tek ta.

Mjekët gjithashtu vazhdojnë të jenë pjesë e denoncimeve për çështjet e sistemit shëndetësor. Gjatë muajit prill mjekët janë ankuar lidhur me largimin e drejtorëve të institucioneve shëndetësore nga puna nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale pa dhënë shkaqet përkatëse të një veprimi të tillë, pavarësisht se disa prej këtyre drejtorëve sapo ishin emëruar në detyrë.

Denoncimet e shumta nga mjekët dhe infermierët vijnë kryesisht në drejtim të keqmenaxhimit të institucioneve shëndetësore, si dhe për mosfunksionim të politikave shëndetësore. Stafit shëndetësor nxjerr në pah mungesat e shumta që ka në menaxhimin e sistemit shëndetësor në Shqipëri.

## Maj 2018

Gjatë muajit maj ka pasur një numër të konsiderueshëm të denoncimeve<sup>10</sup>. Përkatësisht në këtë muaj kanë ardhur 12 denoncime. Shkaqet e këtyre denoncimeve lidheshin me:

---

<sup>10</sup> 2 maj 2018 - 660 milionë lekë për Spitalin e Traumës, pacientët sërish presin në shkallë  
<https://shendetit.com.al/660-milione-leke-per-spitalin-e-traumes-pacientet-serish-presin-ne-shkalle/>

6 maj 2018 - Ikin dritat, QSUT-ja në errësirë totale

<http://propacientit.com/ikin-dritat-qsut-ja-ne-erresire-totale/>

7 maj 2018 - Çmime të ndryshme për të njëjtin ilaç, farmacistët: Do zgjidhet në rrugë ligjore

<http://propacientit.com/cmime-te-ndryshme-per-te-njejtin-ilac-farmacistet-do-zgjidhet-ne-rruge-ligjore/>

9 maj 2018 - “Urgjenca Mjekësore e Tiranës drejt rrenimit – 120 punonjës me 7 ambulanca”

<https://shendetit.com.al/urgjenca-mjekesore-e-tiranes-dreit-rrenimit-120-punonjes-me-7-ambulanca/>

<http://propacientit.com/urgjenca-mjekesore-e-tiranes-dreit-rrenimit-stafi-me-120-veta-punon-me-7-autoambulanca/>

9 maj 2018 - Farmacistët në protestë: Të negociohet kontrata për shitjen e Barnave me Rimbursim

<http://propacientit.com/farmacistet-ne-proteste-te-negociohet-kontrata-per-shitjen-e-barnave-me-rimbursim/>

10 maj 2018 - A janë paguar mjekët për ditët e patronazhimit? Manastirliu shmang pyetjen

<http://propacientit.com/a-jane-paguar-mjeket-per-ditet-e-patronazhimit-manastirliu-shmang-pyetjen/>

14 maj 2018 - Raporti i KLSH, Ministria e Shëndetësisë pranon problemet me protokollet dhe akreditimin e spitaleve

<http://propacientit.com/raporti-i-klsh-ministria-e-shendetesise-pranon-problemet-me-protokollet-dhe-akreditimin-e-spitaleve/>

15 maj 2018 - S'ka parandalim për talaseminë, doktori italian: E pakuptueshme

<https://shendetit.com.al/ska-parandalim-per-talasemine-doktori-italian-e-pakuptueshme/>



Kingdom of the Netherlands



- Keqmenaxhim të institucioneve shëndetësore
- Mosfunksionim të politikave shëndetësore
- Mungesë infrastrukture

Disa prej denoncimeve të ardhura në portalet shëndetësore gjatë muajit maj kanë lidhje pikërisht me çështjet e keqmenaxhimit të institucioneve shëndetësore apo me mosfunksionimin e politikave shëndetësore.

Kështu denoncimi i parë i këtij muaji lidhej me investimet në spitalin e traumës, të cilat sërish kanë lënë pa zgjidhje pacientët të cilët janë detyruar që të presin në shkallë.

Ndërkohë, problematike ka qenë edhe çështja e urgjencës mjekësore të Tiranës e cila po shkon drejt rrënimit, si dhe shkarkimi i punonjësve të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore pa asnjë arsye për më tepër që siç thuhet në denoncim bëhet fjalë për punonjës që nuk kanë asnjë shkelje apo vërejtje gjatë kohës së punës në këtë institucion. Kolegji i Mjekëve të Shqipërisë ka qenë në këtë rast një denoncues i fuqishëm për të gjitha ndodhitë në sistemin shëndetësor.

Gjithashtu, mjekë të caktuar kanë kërkuar të denoncojnë pushimet nga puna duke nxjerrë në pah çështjet e keqmenaxhimit të sistemit shëndetësor.

Dixhitalizimi i shëndetësisë gjithashtu ka qenë një tjetër problematikë e ringritur, ndërkohë që këtë radhë bëhet fjalë për zonat e fshatrave ku mjekët, edhe pse duhet të përdorin dixhitalizimin, nuk kanë internet. Një gjë e tillë ka bërë të pamundur punën e tyre, si dhe funksionimin siç duhet të këtij procesi.

Problematika janë ngritur edhe nga farmacistët, të cilët kanë denoncuar faktin që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka miratuar listën e barnave të rimbursueshme pa asnjë njoftim paraprak, pa u konsultuar me farmacistë dhe një gjë e tillë ka sjellë çmime të ndryshme për të njëjtin ilaç. Një gjë e tillë ka çuar edhe në përballjen gjyqësore midis Urdhrit të Farmacistëve dhe Ministrisë, duke sjellë kështu një tjetër rast që vë në dyshim mënyrën se si funksionojnë politikat shtetërore shëndetësore.

---

19 maj 2018 - Denoncimi/ Lekët e shëndetësisë në duart e specializantëve. Ministria shkarkon punonjësit e Fondit <http://propacientit.com/denoncimi-leket-e-shendetesise-ne-duart-e-specializanteve-ministria-shkarkon-punonjesit-e-fondit/>

30 maj 2018 - Bluzat e bardha denoncojnë shpërdorimin e fondeve publike në shëndetësi <https://shendeti.com.al/bluzat-e-bardha-denoncojne-shperdorimin-e-fondeve-publike-ne-shendetesi/>

30 maj 2018 - Dështimi i dixhitalizimit të mjekësisë, mjekët në fshatra pa internet <https://shendeti.com.al/deshtimi-i-dixhitalizimit-te-mjekesise-mjeket-ne-fshatra-pa-internet/>

31 maj 2018 - Çfarë qarkulloi në emaillet e punonjësve të Fondit, që çoi në pushimin e menjëhershëm nga puna të ish-këshilltarit <https://shendeti.com.al/cfare-qarkulloi-ne-emaillet-e-punonjesve-te-fondit-qe-coi-ne-pushimin-e-menjehershem-nga-puna-te-ish-keshilltarit/>



Kingdom of the Netherlands



Gjithashtu farmacistët kanë vijuar me protesta lidhur me çështjet e barnave, teksa nga Urdhri i Farmacistit është denoncuar fakti se nga ana e Ministrisë po ushtrohet presion mbi farmacitë për të nënshkruar kontratën pavarësisht shkeljeve.

Këtë muaj një nga problematikat ka qenë edhe ajo e talasemisë, në të cilën është denoncuar mungesa e masave parandaluese nga ana e shtetit për këtë sëmundje.

## Qershor 2018<sup>11</sup>

Muaji qershor ka pasur gjashtë denoncime për çështjet e sistemit shëndetësor. Këto denoncime kanë deklaruar probleme të tilla si:

- Shkelje e të drejtave
- Mungesë ilaçesh
- Keqmenaxhim të institucioneve

Punonjësit në sistemin shëndetësor ishin edhe këtë muaj pjesë e denoncimeve. Një nga punonjëset e Fondit të sigurimeve shëndetësore ka denoncuar largimin nga puna 7 muaj para daljes në pension pa apsur asnjë shkelje në kohën e saj të punës.

Nga ana tjetër, mjekët e familjes së qytetit të Durrësit gjithashtu kanë kundërshtuar urdhrin e dhënë nga Ministria e Shëndetësisë për të bërë roje nate në Spitalin e Durrësit në Urgjencën Pediatrike. Denoncimi i ardhur në portalin ProPacientit ka bërë të ditur se mjekët nuk kanë specialitetin e duhur për të punuar në urgjencën pediatrike dhe druajnë se një vendim i tillë i pakonsultuar më parë me ta do të sjellë në gabime mjekësore që mund të jenë fatale për pacientët e vegjël.

Mungesa e ilaçeve vazhdon të jetë problematike, ndërkohë që denoncohet mungesa e barnave të rimbursueshme, të cilat për më tepër nuk kanë as alternativa të tjera. Denoncimi nxori në pah se

---

<sup>11</sup> 1 qershor 2018 - Punonjësja e Fondit: Kam përballuar kancerin në punë. Më hoqën 7 muaj para daljes në pension <http://propacientit.com/punonjesja-e-fondit-kam-perballuar-kancerin-ne-pune-me-hoqen-7-muaj-para-daljes-ne-pension/>

5 qershor 2018 - Shëndetësia, ku thërret gameti. Rama fshin ankesat e qytetarëve

<https://shendetit.com.al/shendetesia-ku-therret-gameti-rama-fshin-ankesat-e-qytetareve/>

6 qershor 2018 - Mungojnë barnat e rimbursueshme, midis tyre barna që nuk kanë alternativa

<http://propacientit.com/mungojne-barnat-e-rimbursueshme-midis-tyre-barna-qe-nuk-kane-alternativa/>

26 qershor 2018 - Urdhri i Ministrisë që ka zemëruar mjekët e familjes, Durrës

<https://shendetit.com.al/urdhri-i-ministrise-qe-ka-zemeruar-mjeket-e-familjes-durres/>

23 qershor 2018 - Kërcënohet infermieri që zbuloi kushtet e vërteta të Urgjencës së Tiranës

<https://shendetit.com.al/kercenohet-infermieri-qe-zbuloi-kushtet-e-verteta-te-urgjences-se-tiranes/>

26 qershor 2018 - E dini si keqtrajtohen të sëmurët me kancer në spitalet tona?!

<http://propacientit.com/e-dini-si-keqtrajtohen-te-semuret-me-kancer-ne-spitalet-tona/>



Kingdom of the Netherlands



pavarësisht se kishin kaluar dy javë nga miratimi i listës së barnave të rimbursueshme, vazhdon të ketë mungesa të theksuara ilaçesh. Mungojnë alternativat e para (pra, ato që rimbursohen 100% nga shteti) dhe medikamente të cilat nuk kanë as alternativa. Nga ana e shoqatës u komunikuan edhe farmacistët të cilët pranuan mungesat në treg të ilaçeve.

## Korrik 2018

Muaji korrik ka shënuar vetëm shtatë denoncime<sup>12</sup>. Edhe këtë muaj si ankesa kryesore kanë qenë:

- Keqmenaxhimi i institucioneve shëndetësore,
- Mosfunksionimi i politikave shëndetësore
- Mungesë e pajisjeve
- Mungesë infrastrukture.
- Mungesë ilaçesh

Medikamentet vazhdojnë të jenë pjesë e denoncimeve edhe për muajin korrik, ndërkohë që këtë herë bëhet fjalë për mungesën e medikamentit bazë për pacientët që kanë kryer transplant të veshkave. Denoncimi është kryer nga një pacient i cili kishte transplantuar veshkën, duke ngritur edhe problemin e zëvendësimit të barnave të duhura me barna që sipas tyre nuk përshkruhen as nga mjekët nefrolog.

Prishja e pajisjeve, si dhe mungesa e tyre nuk ka qenë jashtë vëmendjes as këtë muaj. Pavarësisht se akselatori i dytë linear u vu në punë në muajin qershor, në fillim të muajit korrik ai doli jashtë funksionit. Pacientët u shprehën tepër të indinjuar teksa u duhej të prisnin me orë për të marrë shërbim.

---

<sup>12</sup> 8 korrik 2018 - Debate për radhën tek mjeku, 1 ortoped ambulator mbulon gjithë Tiranën  
<https://shendeti.com.al/debate-per-radhen-tek-mjeku-1-ortoped-ambulator-mbulon-gjithe-tiranen/>

9 korrik 2018 - Jashtë funksionit akselatori i dytë linear

<http://propacientit.com/jashte-funksionit-akselatori-i-dyte-linear/>

9 korrik 2018 - 4 vjet që po sorollatemi për një protezë këmbë

<https://shendeti.com.al/4-vjet-qe-po-sorollatemi-per-nje-proteze-kembe/>

11 korrik 2018 - Banka e Gjakut: Jashtë vëmendjes së shtetit dhe ... personelit

<https://shendeti.com.al/banka-e-gjakut-jashte-vemendjes-se-shtetit-dhe-personelit/>

12 korrik 2018 - Mjekë nuk ka, sepse mjekët po ikin

<https://shendeti.com.al/mjeko-nuk-ka-sepse-mjeket-po-ikin/>

16 korrik 2018 - Urgjenca e Sëmundjeve të Brendshme mungesë personeli, pacientët të shtrirë nëpër karrige

<https://www.facebook.com/1402603996715491/photos/a.1402618536714037.1073741828.1402603996715491/1877262012583018/?type=3&theater>

26 korrik 2018 - Mungon medikamenti bazë për pacientët që kanë kryer transplant të veshkave.

<https://www.facebook.com/1402603996715491/photos/a.1402618536714037.1073741828.1402603996715491/1887525071556712/?type=3&theater>



Kingdom of the Netherlands



Problematike ka qenë edhe mungesa e personelit mjekësor dhe specialistëve. Në Tiranë tashmë është vetëm një mjek ortoped i cili mbulon shërbimin ambulator duke çuar në probleme shumë të mëdha sidomos me radhët e pritjes. Pacientët jo rrallë krijojnë konflikte në orët e shumta të pritjes para derës së mjekut.

E njëjta gjë duket se ka ndodhur edhe në urgjencën e QSUT-së në të cilën pacientët denoncojnë se duhet të presin për orë të të tëra për shkak se punon vetëm një mjek.

\*\*\*

Shoqata "Together for Life" gjatë projektit ka mbajtur komunikim zyrtar me institucione të ndryshme. Nga ana e Kryeministrit është kërkuar pesë muaj më parë një informacion lidhur me ankesat e mbërritura në portalin [www.stopkorrupsionit.al](http://www.stopkorrupsionit.al)<sup>13</sup> dhe më tej në portalin [www.shqipëriaqëduam.al](http://www.shqipëriaqëduam.al).<sup>14</sup>

Në përgjigjen e ardhur nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje rezulton se gjatë vitit 2017 në portalin qeveritar antikorrupsion [shqipëriaqëduam.al](http://shqipëriaqëduam.al) kanë mbërritur 1585 ankesa, nga të cilat 110 përfshinin sektorin e shëndetësisë.

Ndërkohë për vitin 2018 (6-mujori i parë) rezulton të kenë mbërritur 13830 ankesa, nga të cilat 1325 ankesa janë për sektorin e shëndetësisë.

Nga ana e institucionit ankesat janë kategorizuar sipas tipologjisë duke u ndarë në:

- Ankesa ndaj shërbimit nga personeli mjekësor nëpër institucione të kujdesit parësor dhe spitalor
- Ankesa për mungesë medikamentesh
- Ankesa në lidhje me rezultatet e konkursit të zhvilluar në portalin "Infermierë për Shqipërinë"
- Ankesa mbi shkualifikimin nga ndihma ekonomike
- Kërkesa për ndërhyrje kirurgjikale jashtë vendit
- Kërkesa për përfshirjen në rimbursime medikamentesh për sëmundje të caktuara
- Kërkesa për informacion dhe orientim për trajtimin e sëmundjeve të ndryshme

Nga këto të dhëna rezulton se gjatë vitit 2017 sektori i shëndetësisë ka zënë 7% të ankesave të përgjithshme, ndërkohë që gjatë vitit 2018 kanë zënë 9.6% të ankesave duke shënuar kështu një rritje jo vetëm të numrit të përgjithshëm, por edhe një rritje në përqindjen që zënë në raport me ankesat e tjera.

<sup>13</sup> Ky portal ka funksionuar si mjet për të denoncuar korrupsionin përgjatë viteve 2015-2017. U mbyll pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017.

<sup>14</sup> Ky portal filloi të funksionojë me ardhjen në pushtet të qeverisë së re duke përdorur logon me të cilën Partia Socialiste fitoi zgjedhjet.



Kingdom of the Netherlands



Ndërkohë, deri në maj të vitit 2017, më shumë se dy vjet nga ndërtimi i saj, faqja stopkorrupsionit.al kishte një numër prej 16220 denoncimesh. Përgjatë gjithë kohës së funksionimit të kësaj faqeje, për shëndetësinë kishin mbërritur shëndetësia me 1605 ankesa, nga të cilat dy ishin dërguar në prokurori.

Në 9 korrik 2018, në një tryezë të organizuar nga USAID me shoqërinë civile dhe institucionet e pavarura, Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca, deklaroi se "në fillim të vitit 2014 Qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë inicioi një fushatë kundër korrupsionit në përgjithësi, duke hapur edhe një faqe në internet [www.stopkorrupsionit.al](http://www.stopkorrupsionit.al). Kjo fushatë me qëllim luftën ndaj korrupsionit dhe përmirësimit të kujdesit shëndetësor pati efekt negativ në motivimin e mjekëve për të punuar".

Në fakt, denoncimet e ardhura në portalet e organizatës, të cilët në një pjesë të mirë të tyre kanë si denoncues vetë stafet mjekësore, tregojnë se në të vërtetë brenda këtij stafi ka një revoltë të madhe ndaj sistemit ekzistues.

Mjekët e konsiderojnë veten viktimë të sistemit shëndetësor dhe konfliktet me pacientët i shohin më shumë si të nxitura për shkak të mungesave në sistemin shëndetësor dhe nxitjes negative që bëhet nga shteti për denoncime.

Në kuadër të veprimtarisë së saj, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe veçanërisht në mbrojtje të të drejtave të pacientëve, shoqata "Together for Life" do të vazhdojë të denoncojë rastet korruptive, problematikat që ekzistojnë, duke nxitur demokracinë dhe respektimin e të drejtave të njeriut në sistemin shëndetësor.

**Përgatitën raportin: Arlinda Shehu Gjypi  
Blertina Koka  
Denisa Canameti**